



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:151303
Datë: 21.06.2024
Numri i dokumentit: 05847902

KPPP.nr.84/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Raiffeisen Bank Kosovë, me seli në Prishtinë Rr. "UÇK"-së, nr.5, kundër debitorëve 1.) N.P.N. "Hidroterm" SH.P.K., me NRB: 70035994, me seli në Suharekë rr. "Brigada 123", 2.) B.K. me adresë në Suharekë rr."..." p.n., 3.)M.V. me adresë në fshatin ..., Suharekë, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Nadire Hoxha, avokate nga Suhareka, duke vendosur sipas parashtresës së debitorëve për tërheqjen e prapësimit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.180/18 të datës 27.03.2018, të Përmbartuesit Privat Ilir Z. Mulhaxha, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 21.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hudhet si i palejuar prapësimi i debitorëve 1.) N.P.N. "Hidroterm" SH.P.K., me NRB: 70035994, 2.) B.K. dhe 3.) M.V., i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.180/18 të datës 27.03.2018, të Përmbartuesit Privat Ilir Z. Mulhaxha.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.180/18 i datës 27.03.2018, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Ilir Z. Mulhaxha.

A r s y e t i m

Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit Privat Ilir Z. Mulhaxha, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përmbartimor me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Marrëveshjes mbi linjën multikreditore për kapital punues NR.200666635 Maj 2010, Marrëveshja mbi Letër Garancionin me numër 200674163 të datës 26.05.2011, Marrëveshjes Kryesore me numër 312 të datës 27.06.2011, Marrëveshjes mbi Letër Garancionin nr.200674186

në kuadër të Marrëveshjes Kryesore nr.312 të 27.06.2011, Marrëveshjes mbi Linjën Multikreditore për Kapital Punues nr.900339/800745 në kuadër të Marrëveshjes Kryesore me numër 312, Janar 2013; Marrëveshjes mbi Linjën e Kredisë për Produktet e Financave Tregtare me numër 900339/800756 në kuadër të Marrëveshjes Kryesore me numër 312, Janar 2013; Marrëveshjes mbi Linjën e Kredisë për Produktet e Financave Tregtare nr.900617/801404 në kuadër të Marrëveshjes Kryesore me numër 312, e datës 29.01.2014; Marrëveshjes mbi Letër Garancionin nr.900617/801487 në kuadër të Marrëveshjes Kryesore me numër 312 e datës 29.01.2014; Marrëveshjes mbi Letër Garancionin nr.900617/801405 në kuadër të Marrëveshjes Kryesore me numër 312 e datës 29.01.2014; Shtojcën nr. 2 për Linjën Multikreditore për kapital punues nr.200666635 e datës 19.05.2011; Shtojcës nr.2 e Marrëveshjes mbi Linjën Multikreditore per Kapital Punues me numër 200666635 e Marrëveshjes mbi Linjën Multikreditore per Kapital Punues e datës 29.01.2014; Hipotekës dhe Garancionit nr. 900339/800745 në kuadër të Marrëveshjes Kryesore nr.312; Shtojcës nr.3 e Marrëveshjes mbi Linjën Multikreditore për Kapital Punues me numër 200666635, e Marrëveshjes mbi Linjën Multikreditore për Kapital Punues, nr.900339/800745 në kuadër të Marrëveshjes Kryesore me numër 312 e datës 27.03.2014; Shtojcës numër 3 e Marrëveshjes mbi Linjën Multikreditore për Kapital Punues nr.200666635, e Marrëveshjes mbi Linjën Multikreditore për Kapital Punues, nr. 900339/800745 në kuadër të Marrëveshjes Kryesore me numër 312 e datës 27.03.2014; Shtojcës numër 4 e Marrëveshjes mbi Linjën Multikreditore për Kapital Punues nr. 200666635, e Marrëveshjes mi Linjën Multikreditore për Kapital Punues, nr.900339/800745 në kuadër të Marrëveshjes Kryesore me numër 312 e datës 05.12.2014; Shtojcës numër 5 e Marrëveshjes mbi Linjën Multikreditore për Kapital Punues nr.200666635, e Marrëveshjes mbi Linjën Multikreditore për Kapital Punues nr.900339/800745 në kuadër të Marrëveshjes Kryesore me numër 312, e datës 25.02.2015; Shtojcës numër 3 e Marrëveshjes mbi Letër Garancionin nr. 900617/801487 në kuadër të marrëveshjes Kryesore nr. 312 e datës 24.03.2016; Shtojcës numër 6 e Marrëveshjes mbi Linjën Multikreditore për Kapital Punues nr.200666635 dhe e Marrëveshjes mbi Linjën Multikreditore për Kapital Punues nr.900339/80745 në kuadër të Marrëveshjes Kryesore nr.312 e datës 02.06.2016; Shtojcës numër 6 e Marrëveshjes nr.900617/801487 e Marrëveshjes mbi letër Garancionin me nr.200674163 në kuadër të Marrëveshjes Kryesore nr.312 e datës 25.04.2017; Shtojcës numër 7 e Marrëveshjes mbi Linjën Multikreditore për Kapital Punues nr.200666635 dhe e Marrëveshjes mbi Linjën Multikreditore për Kapital Punues nr.900339/800745, e datës 25.04.2017; Shtojcës numër 7 e Marrëveshjes mbi

Letër Garancionin dhe Garancionin nr. 900617/801487 dhe e Marrëveshjes mbi Garancionin me numër 200674163 në kuadër të Marrëveshjes Kryesore nr.312 e datës 20.07.2017; Shtojcës nr.8 e Marrëveshjes mbi Letër Garancionin dhe Garancionin nr.900617/801487 dhe e Marrëveshjes mbi Garancionin me numër 200674163 në kuadër të Marrëveshjes Kryesore nr. 312 e datës 03.11.2017; Shtojcës numër 9 e Marrëveshjes mbi Letër Garancionin dhe Garancionin nr. 900617/801487 dhe e Marrëveshjes mbi Garancionin me numër 200674163 në kuadër të Marrëveshjes Kryesore nr. 312 e datës 30.11.2017, duke detyruar debitorët t'ia paguajnë borxhin e mbetur në shumë prej 2,042.311.25 €, ka urdhëruar të gjitha Institucionet Financiar se në rast se kanë mjete atëherë të transferohen përmes llogarisë së veçantë të organit përmbarues me qëllim të përmbylljes së obligimit. Në rast të mos realizimit me anë të llogarive bankare, të sekuestrohet kolaterali i debitorëve sipas kontratës së pengut dhe të njëjtat ti dorëzohen kreditorit për ti shitur, që nga çmimi i shitblerjes të përmbushet obligimi i debitorit, si dhe të detyrohen debitorët që të kompensojnë shpenzimet procedurale aq sa ato do jenë të llogaritura nga zyra përmbarimore sipas udhëzimit Administrativ nr.06/2014 Udhëzim për tarifat për shpërblimet dhe kompensimin për përmbaruesit privat.

Kundër urdhrimit për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor me datën 05.04.2018, prapësim kanë paraqitur debitorët, ndërsa me datën 11.04.2018, përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori.

Debitori me datën 31.08.2021, me anë të parashtresës e ka njoftuar Gjykatën se e tërheq prapësimin e paraqitur ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr.180/18 të datës 27.03.2018, pasi që palët në këtë procedurë janë dakorduar që borxhin ta përfundojnë me anë të marrëveshjes për pagesën e borxhit.

Sipas nenit 67 par.1 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje referuar si LPP) prapësimi përcaktohet si mjet i rregullt i goditjes dhe duke marrë parasysh faktin se me këtë ligj nuk është përcaktuar mënyra e vendosjes në rastet e tërheqjes së prapësimit nga e ana e debitorit dhe duke u bazuar në nenin 17 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në procedurën përmbarimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër.”*, gjykata për vendosjen në rastin konkret zbatoi përshtatshmërisht dispozitat e LPK-së.

Në nenin 186 par. 3 të LPK-së, përcaktohet se *“Ankesa është e palejueshme po që se e ka paraqitur personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e saj, apo personi që ka hequr dorë nga e drejta e ankimit apo që e ka tërhequr ankesën e paraqitur, apo në qoftë se personi që e ka paraqitur ankesën nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës.*

Gjykata pas vlerësimit të parashtresës së debitorit për tërheqjen e prapësimit të ushtruar me datën 31.08.2021, dhe duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, gjeti se prapësimi është i palejuar për shkak prapësimi është tërhequr nga ana e debitorit dhe në mbështetje të nenit 73. par.3 të LPP-së, me të cilën përcaktohet se *“Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar”*, e ka hedhur prapësimin si të palejuar, duke vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe e ka lënë në fuqi urdhrin përmbarimor sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 73.3 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr 84/22, datë 21.06.2024.

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.